

# SICPA

Kodi i  
Sjelljes



SICPA

Enabling trust

SICPA  
**KODI I SJELLJES**

# TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA 01	1.1	BISEDË ME PHILIPPE AMON	6
<b>BESIMI ËSHTË BIZNESI YNË</b>	1.2	VLERAT TONA, MISIONI YNË	8
	<hr/>		
PJESA 02	2.1	RESPEKTONI LIGJIN, NDIQNI KODIN	12
<b>PËRGJEGJËSIA JUAJ</b>	2.2	PRITSHMËRITË TONA	14
	<hr/>		
PJESA 03	3.1	DIVERSITETI DHE PËRFSHIRJA	18
<b>NJERËZIT TANË</b>	3.2	SHËNDETI DHE SIGURIA	20
	3.3	KONFLIKTI I INTERESIT	22
	3.4	KOMUNIKIMI NË MEDIAN SOCIALE	23

PJESA 04	4.1	KORRUPSIONI	26
<b>INTEGRITETI I BIZNESIT TONË</b>	4.2	DHURATAT DHE ARGËTIMET	29
	4.3	BASHKËVEPRIMI ME ZYRTARËT E QEVERISË	30
	4.4	BASHKËPUNIMI ME PALËT E TRETA	32
	4.5	LIGJI I KONKURENCËS	34
	4.6	KONTROLLET E TREGTISË	36

PJESA 05	5.1	RAPORTIMI FINANCIAR	40
<b>INTEGRITETI YNË FINANCIAR</b>	5.2	KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE	41
	5.3	MASHTRIMI	42
	5.4	DONACIONET POLITIKE DHE BAMIRËSE	44
	5.5	LOBIMI DHE ÇËSHTJET POLITIKE	45

PJESA 06	6.1	SIGURIA E PRODUKTIT	49
<b>SJELLJA JONË NË TREG</b>	6.2	MJEDISI	50
	6.3	PRONËSIA INTELKTUALE	53
	6.4	KONFIDENCIALITETI	54
	6.5	SIGURIA INFORMATIVE DHE KIBERNETIKE	56
	6.6	MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSIA	58
	6.7	MBËSHTETJA E KOMUNITETIT	59
	6.8	PUNA DHE TË DREJTAT E NJERIUT	60
	6.9	ZINXHIRI I FURNIZIMIT	61

PJESA 07	7.1	KË TË PYESNI	64
<b>KËRKIMI I NDIHMËS DHE UDHËZIMIT</b>	7.2	NGRITJA E SHQETËSIMEVE - <i>SPEAK UP</i>	67

PJESA 01

# BESIMI ËSHTË BIZNESI YNË

NË KËTË PJESE

---

- 1.1 BISEDË ME PHILIPPE AMON
- 1.2 VLERAT TONA, MISIONI YNË

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

---

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

---

03  
NJERËZIT  
TANË

---

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

---

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

---

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

---

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

---



## BISEDË ME PHILIPPE AMON

**Qëllimi i SICPA është *Enabling Trust* ("Krijimi i Besimit"). Çfarë do të thotë kjo?**

Besimi është themeli i harmonisë sociale, mirëqënies ekonomike dhe ecurisë civile. Për thujtë një shekull, SICPA ka mundësuar besimin e nevojshëm për shoqëritë moderne që të funksionojnë përballë pasigurisë ekonomike, trazirës teknologjike dhe sfidave të reja shoqërore.

SICPA mundëson krijimin e besimit mes institucioneve shtetërore dhe shtetasve individualë duke mbrojtur sovranitetin e zinxhirëve strategjikë të vlerave, duke garantuar vërtetësinë e të dhënave dhe duke siguruar integritetin e kartëmonedhave, transaksioneve, shërbimeve elektronike dhe dokumentave zyrtare. Përveç kësaj, SICPA mundëson krijimin e besimit mes kompanive dhe klientëve të tyre me zgjidhje për vërtetimin e produkteve dhe duke mbrojtur aktorët legjitimë ekonomikë dhe konsumatorët individualë nga produktet e falsifikuara.



*Pajtueshmëria me ligjin dhe bërja e biznesit me integritet nuk janë opsionale. Ato janë thelbësore si bazë për besimin, të cilat qëndrojnë në zemër të asaj që bëjmë.*



**Si lidhet ky Kod i Sjelljes me qëllimin e *Enabling Trust*?**

Ky Kod përcakton mënyrën e të bërit biznes me integritet, sesi jemi të përkushtuar ndaj punonjësve tanë dhe palëve të interesuara dhe se çfarë presim nga njëri-tjetri dhe kushdo në SICPA. Kjo ndodh sepse besimi që klientët dhe partnerët tanë të biznesit na japin varet nga integriteti ynë. Pa integritet nuk mund të ketë besim.

Prandaj, ky Kod nuk i drejtohet vetëm punonjësve tanë të SICPA's, por edhe të gjithë furnitorëve tanë, partnerëve të biznesit dhe klientëve. Ndërsa ne të gjithë punojmë fort në SICPA për të realizuar vizionin tonë të "*Enabling Trust*" dhe për të zhvilluar biznesin tonë në mënyrë të qëndrueshme, duhet të sigurohemi gjithmonë që jo vetëm e zbatojmë ligjin, por edhe bëjmë biznes me integritet.

**A duhet parë atëherë ky kod si një dokument udhëzues?**

Absolutisht. Ky kod është një dokument gjithëpërfshirës që dua ta shoh si një busull sjelljeje. Shumë prej temave që trajton mbështeten nga politika dhe procedura shtesë. Ato janë burime të dobishme, veçanërisht kur përballemi me situata ose vendime të vështira.

**A ka ndonjë kanal të preferuar për dikë që të bëjë pyetje ose të ngrejë shqetësimet e tij?**

Së pari, unë i nxit të gjithë të bëjnë pyetje për të sfiduar për përmirësim ose për të ngritur shqetësime, veçanërisht kur jeni në dyshim. Në SICPA, ne promovojmë një kulturë *Speak Up* duke i nxitur punonjësit tanë të flasin me menaxherët e tyre, me departamentet e tjera, ekipin e drejtuesve të lartë ose me mua. E njëjta gjë shkon për palët tona të jashtme të interesuara. Në fund fare, kushdo mund të përdorë sistemin tonë të Whistleblowing, *Linjën Speak Up* të SICPA.

**Ndonjë fjalë përmbyllëse?**

Mbështetem te çdo punonjës i SICPA's që të marrë vendimet e duhura në çdo kohë dhe për të kontribuar në ruajtjen e reputacionit dhe suksesit tonë afatgjatë. Pajtueshmëria me ligjin dhe bërja e biznesit me integritet nuk janë opsionale. Ato janë thelbësore si bazë për besimin, të cilat qëndrojnë në zemër të asaj që bëjmë.

**PHILIPPE AMON**  
KRYETARI DHE DREJTORI I PËRGJITHSHËM I  
SICPA

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## VLERAT TONA, MISIONI YNË



**Në botën komplekse ku operojmë, vlerat tona janë busulla e njerëzve tanë. Ato janë thelbësore për identitetin tonë dhe për atë që ne përfaqësojmë, si dhe ato na ndihmojnë të veprojmë në një mënyrë që është konsistente me kulturën tonë të përbashkët.**

Ne presim që të gjithë punonjësit tanë të përqafojnë dhe të sillen në përputhje me pesë vlerat tona thelbësore:

- Respekti
- Përkushtimi
- Solidariteti
- Kompetenca
- Besimi

Në mënyrë të ngjashme, presim që të gjithë punonjësit tanë të interpretojnë dhe t'i binden këtij Kodi Sjelljeje duke mbajtur parasysh këto vlera.

### VLERAT TONA NË PRAKTIKË



#### Respekti

Ne e dëgjojmë dhe e pranojmë njëri-tjetrin, jemi të ndërgjegjshëm për individualitetin dhe ndryshimet tona.



#### Përkushtimi

Ne angazhohemi, vendosim dhe veprojmë me bindje, kreativitet, guxim, këmbëngulje dhe energji për suksesin tonë kolektiv.



#### Solidariteti

Ne inkurajojmë kohezionin në grup, ndajmë përgjegjësitë dhe qëndrojmë të bashkuar.



#### Kompetenca

Ne përdorim, ndajmë dhe vazhdimisht zhvillojmë ekspertizën tonë.



#### Besimi

Ne krijojmë një mjedis dhe kultivojmë marrëdhënie të bazuara në shkëmbim, transparencë dhe integritet për të inkurajuar përmbushjen individuale dhe performancën e qëndrueshme në grup.

## PJESA 02

# PËRGJEGJËSIA JUAJ

Realizimi i qëllimit të kompanisë sonë në lidhje me Mundësimin e Besimit është përgjegjësia e çdokujt. Këtë mund ta arrijmë vetëm përmes përpjekjes kolektive, duke i respektuar të gjitha ligjet e zbatueshme dhe duke ndjekur politikatat tona të brendshme.

## NË KËTË PJESE

---

- 2.1 RESPEKTONI LIGJIN, NDIQNI KODIN
- 2.2 PRITSHMËRITË TONA

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

---

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

---

03  
NJERËZIT  
TANË

---

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

---

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

---

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

---

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

---

## RESPEKTONI LIGJIN, NDIQNI KODIN

Ne i kërkojmë çdo punonjësi, zyrtari, drejtori, individi ose entiteti që përfaqësojnë ose u shërbejnë interesave të SICPA's të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për aktivitetet e tyre, për ose në emër të kompanisë.

Ky Kod ju udhëzon duke nënvizuar sjelljen e parashikuar në fusha kyçe, por mbani parasysh që veprimi në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme mbetet përgjegjësia juaj individuale.

Kryerja e biznesit për SICPA'n nuk duhet t'ju kërkojë asnjëherë të shkelni ose anashkaloni ligje dhe rregullore të tilla, apo të kompromentoni Kodin tonë.

SICPA operon në një mjedis kompleks dhe duke qenë novatore dhe globale do të thotë të përballet rregullisht me pyetje ose situata të reja. Menaxheri juaj do t'ju ndihmojë të bëni gjënë e duhur.

### KËRKONI NDIHMË NËSE

Mendoni se nuk mund të përmbushni objektivat tuaja të biznesit ose të veproni në përputhje me udhëzimet e supervizorit tuaj me integritet.

Nuk jeni i sigurt se cilat ligje ose rregullore zbatohen për aktivitetet tuaja.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT





## PRITSHMËRITË TONA

Ne u kërkojmë të gjithë njerëzve tanë dhe partnerëve të biznesit të veprojnë në përputhje me këtë Kod.

### PRESIM QË JU



**Ta lexoni**, kontrolloni që e kuptoni dhe mënyrën si ta zbatoni.



**Të kërkoni udhëzim** kur nuk jeni i sigurt se cili rregull duhet zbatuar.



**Të ngrini zërin** nëse mendoni se të tjerët mund të mos pajtohen.

### NËSE JENI MENAXHER OSE DREJTUES I SICPA'S, PRESIM GJITHASHTU QË JU TË



**Jeni shembull** me fjalët dhe veprimet tuaja.



**Promovoni dhe shpjegoni** këtë Kod dhe politikat e zbatueshme të SICPA's përmes diskutimit dhe trajnimit.



**Inkurajoni punonjësit** të vijnë te ju me shqetësimet ose pyetjet e tyre.



**Dëgjoni shqetësimet ose pyetjet** dhe t'i merrni seriozisht raportet e shkeljeve.



**Mbështetni ata që vijnë e përballen** dhe sigurohuni që askush të mos pësojë hakmarrje për shkak se ngrë zërin.



**Përshkallëzoni dhe/ose ndërmerrni veprimet e duhura** kur ju silltet në vëmendje një shqetësim.

## PJESA 03

# NJERËZIT TANË

Suksesin tonë ia detyrojmë njerëzve tanë dhe jemi të përkushtuar ndaj zhvillimit, sigurisë dhe mirëqenies së fuqisë sonë punëtore.

Të gjithë duhet të ndihemi krenar për rolin tonë në SICPA dhe të sigurt që mund ta përmbushim potencialin tonë, të çliruar nga diskriminimi dhe ngacmimi.

Ne punojmë së bashku në një ambient paanësie dhe respekti reciprok.

## NË KËTË PJESE

---

- 3.1 DIVERSITETI DHE PËRFSHIRJA
- 3.2 SHËNDETI DHE SIGURIA
- 3.3 KONFLIKTI I INTERESIT
- 3.4 KOMUNIKIMI NË MEDIAN SOCIALE

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

---

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

---

**03  
NJERËZIT  
TANË**

---

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

---

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

---

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

---

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

---

# DIVERSITETI DHE PËRFSHIRJA

Përkushtimi ynë për një fuqi punëtore të larmishme dhe gjithëpërfshirëse jo vetëm që forcon kulturën tonë, por na fuqizon në tregun botëror.

## VENDI YNË I PUNËS ËSHTË I LARMISHËM



Ne duam të tërheqim, mbajmë dhe kultivojmë talentet më të mira, nga një grup që pasqyron larminë e pranisë sonë botërore.

Ne besojmë fuqimisht se perspektivat e ndryshme nxisin inovacionin dhe e bëjnë vendin tonë të punës më kreativ dhe stimulues.

## VENDI YNË I PUNËS ËSHTË PËRFSHIRËS



Duam që të gjithë njerëzit tanë të ndihen se mund dhe duhet të kontribuojnë, pavarësisht kualifikimit të tyre personal.

Secili prej nesh duhet të ndihet i fuqizuar për të ndjekur përsosmërinë profesionale, teknike dhe shkencore pa pasur frikë nga çdo lloj diskriminimi.

## MENDONI

- Kur zgjidhni kandidatë për një pozicion të ri apo ngritje në detyrë, sigurohuni që vendimi juaj të bazohet në kualifikimet e individit dhe aftësinë objektive për të kontribuar.

**Diversitet apo shumëllojshmëri do të thotë** të pranosh dhe respektosh dallimet individuale, si statusi prindëror, gjinia, feja, raca, përkatësia etnike, orientimi seksual, aftësitë fizike, mosha, statusi social-ekonomik, besimet politike dhe ideologjitë e tjera.

**Përfshirje do të thotë** të bëhesh kureshtar për dallimet tona dhe të sigurosh në mënyrë aktive që secili të ndihet i mirëkuptuar dhe i vlerësuar për kontributin e tij.

## VENDI YNË I PUNËS ËSHTË I PAANSHËM



Jemi të përkushtuar për të eliminuar paragjykimet dhe diskriminimin në të gjitha proceset tona të brendshme në mbarë botën, në çdo aspekt të punësimit, nga rekrutimi deri tek ecuria në karrierë.

Ne ofrojmë paketa të drejta dhe të paanshme kompensimi që reflektojnë performancën individuale dhe monitorojmë në mënyrë aktive pagesën dhe përfitimet e njerëzve tanë për të identifikuar dhe adresuar pabarazitë e mundshme.

## VENDI YNË I PUNËS ËSHTË PA NGACMIME



Ne nuk tolerojmë asnjë lloj ngacmimi, qoftë seksual apo tjetër.

Grupimet, bullizimi dhe format e papërshtatshme të komunikimit nuk kanë vend në mjedisin tonë të punës.

Toni dhe mënyra jonë e komunikimit duhet të jetë gjithmonë e vëmendshme, e respektueshme dhe profesionale, kurrë agresive apo shpërfillëse.

## SHËNDETI DHE SIGURIA

**Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së njerëzve tanë është gjithmonë përparësia jonë kryesore.**

- ✓ Çdo ditë përpiqemi të ofrojmë një vend pune të sigurt e të shëndetshëm për punonjësit tanë dhe këdo që punon me ne, të tillë si shitësit, nënkontraktorët, klientët dhe partnerët në biznes.
- ✓ Ne mbetemi të vetëdijshëm për të gjitha rreziqet profesionale të krijuara nga aktivitetet tona dhe sigurojmë që ato të zbuten në mënyrë të përshtatshme dhe efektive.
- ⊗ Nuk bëjmë kompromis me mirëqenien mendore dhe fizike të njerëzve tanë.

### MENDONI

- Kur përballeni me rreziqe të sigurisë, mbroni veten dhe të tjerët dhe ngrini shqetësimet tuaja.
- Kurrë mos vendosni objektiva biznesi që rrezikojnë shëndetin tuaj apo masat e sigurisë.



01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## KONFLIKTI I INTERESIT

Ne i menaxhojmë interesat tona të jashtme në mënyrë transparente për të shmangur ndonjë marrëdhënie të papërshtatshme dhe për të mbrojtur reputacionin tonë.

E respektojmë privatësinë e çdo kolegu në SICPA dhe përgjithësisht nuk duam të ndërhyjmë në interesat private të tyre apo familjeve të tyre. Megjithatë, në situata të caktuara interesa të tilla mund të përplasen me interesa legjitime të biznesit tonë.

Sigurohemi që situata të tilla të zbulohen dhe të menaxhohen si duhet për të shmangur ndonjë parregullsi ose dëmtim reputacioni të palëve të përfshira.

### MENDONI

- Edhe nëse ligjet nuk shkelen, konfliktet e interesit mund të vazhdojnë të çojnë në sjellje joetike ose të padëshiruara.
- Qofshin të vërteta apo të perceptuara, ato kërkojnë transparencë dhe menaxhohen më mirë kur zbulohen, diskutohen, merret vendim për to dhe dokumentohen.

## KOMUNIKIMI NË MEDIAN SOCIALE

Ne e përdorim median sociale me kujdes dhe në linjë me vlerat tona.



### Pajtueshmëria

Prania jonë në platformat e medias sociale si punonjës ose përfaqësues të SICPA's duhet të reflektojë vlerat e kompanisë dhe të veprojë në përputhje me ligjet në fuqi.



### Konfidencialiteti

Ne nuk e përdorim kurrë median sociale për të kryer diskutime biznesi. Edhe kur një kanal shfaqet si privat, nuk ndajmë informacione konfidenciale.



### Sensi i përbashkët

Ne duhet t'i shprehim mendimet tona personale me gjykim dhe sens të përbashkët, duke respektuar kolegët, klientët dhe partnerët tanë.

## PJESA 04

# INTEGRITETI I BIZNESIT TONË

Për të qenë të besueshëm si *Trust Enablers* ("Mundësues Besimi") në më tepër se 180 shtete në botë, duhet të veprojmë në përputhje me ligjet në këto tregje të ndryshme dhe sipas vlerave tona.

Integritet do të thotë të bësh atë që është e drejtë, jo domosdoshmërisht atë që është e lehtë ose menjëherë fitimprurëse. Do të thotë t'u largohesh mundësive për biznes që nuk mund të ndiqen pa kompromentuar vlerat tona.

## NË KËTË PJESE

- 4.1 KORRUPSIONI
- 4.2 DHURATAT DHE ARGËTIMET
- 4.3 BASHKËVEPRIMI ME ZYRTARËT E QEVERISË
- 4.4 BASHKËPUNIMI ME PALËT E TRETA
- 4.5 LIGJI I KONKURENCËS
- 4.6 KONTROLLET E TREGTISË

01  
BESIMI ËSHTE  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

# KORRUPSIONI

Ne nuk e tolerojmë kurrë ryshfetin ose korrupsionin.

Ryshfeti dhe transaksionet e tjera korruptive nuk janë të kufizuara në para kesh. Ato mund të marrin formën e një dhurate, ftese në një ngjarje, donacion për bamirësi, mundësie pune – gjithçka që, nëse ofrohet ose premtohet, mund të ndikojë në vendimin e marrësit ose përfundimin e transaksionit të biznesit.

Ne nuk veprojmë kurrë me qëllim korruptiv. Nuk japim ose marrim përfitime të papërshtatshme në këmbim të diçkaje me vlerë.

Ne nuk ofrojmë, premtojmë, pranojmë apo autorizojmë ryshfete. Këto dhe transaksione të tjera korruptive nuk janë të kufizuara vetëm në para kesh.

Presioni për t'u përfshirë në transaksione korruptive mund të lindë në shumicën e aktiviteteve tona rutinë të biznesit: kur kërkojmë të sigurojmë një shitje, kur negociojmë me një shitës, kur aplikojmë për një licensë ose leje.

Ne qëndrojmë gjithashtu vigjilent dhe të përmbajtur nga veprimet që mund të perceptohen si korruptive nga partnerët tanë ose vëzhguesit e jashtëm.

Mbani parasysh se rregulla specifike zbatohen sa herë që përfshihet një zyrtar qeveritar.

## MENDONI

- Çdo kërkesë për ryshfet ose avantazh të panevojshëm që nuk raportohet dhe për të cilin nuk veprohet si duhet mund të kthehet në fund në një bumerang. Edhe perceptimi i bërjes biznes jo si duhet mund të ndikojë për keq në reputacionin dhe veprimtarinë tona.
- Në SICPA ne nuk e pranojmë kurrë shprehjen 'kështu bëhet biznes këtu' si një justifikim për të hyrë në transaksione korruptive.

## SHEMBUJ

- Pagujini komision një ndërmjetësuesi vetëm kur e keni kuptuar dhe dokumentuar vlerën e tyre të shtuar legjitime në transaksion.
- Kurrë mos e ftoni një klient për argëtim në fundjavë me shpenzimet e kompanisë.
- Shmangni dhënien e një vendi pune ose marrëveshjeje këshillimi një të afërmi të klientit.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## DHURATAT DHE ARGËTIMI

**Ne e mbajmë shkëmbimin e dhuratave dhe argëtimit brenda kufijve të një mirësjellje të arsyeshme biznesi.**

- ✓ Ne përdorim sensin e përbashkët dhe u referohemi rregulloreve kur vendosim nëse duhet të ofrojmë ose pranojmë dhurata, vakte ushqimore ose mikpritje.
- ✓ Ne e marrim parasysh sesi shkëmbimi i dhuratave të tilla mund të perceptohet nga jashtë, në kontekstin e marrëdhënies së SICPA's me palën tjetër.
- ✓ Politikat tona përcaktojnë pragjet dhe nivelet e arsyeshme të miratimit për të dhuruar dhe marrë dhurata nga zyrtarë joqeveritarë. Rregulla specifike zbatohen për ndërveprimet me një zyrtar qeverie.
- ✗ Shkëmbimi rastësor i dhuratave të vogla dhe ftesave për argëtim është pjesë e ndërtimit të një marrëdhënieje biznesi, por kur dhurata të tilla përdoren për të influencuar padrejtësisht në vendimet e biznesit, nuk duhet t'i pranojmë.
- ✗ Në çfarëdo konteksti, dhuratat në para ose vlerë të barasvlershme me paratë si kuponët, ndalohen rreptësisht.

### MENDONI

- Shumë organizata kanë rregulla në lidhje me dhuratat dhe argëtimet. Para se të ofroni një dhuratë ose ftesë, merrni parasysh rregullat e kompanisë homologe.
- Merrni gjithmonë parasysh sesi do të perceptohet dhënia ose pranimi i dhuratave nga kolegët ose klientët tuaj.



## NDËRVEPRIMI ME ZYRTARËT E QEVERISË

Ne promovojmë ndërveprimet transparente dhe të ligjshme me zyrtarët e qeverisë.

Ndërveprimet me zyrtarët e qeverisë janë një pjesë integrale e biznesit së SICPA's. Në përgjithësi ato u nënshtrohen rregullave më kufizuese dhe shqyrtimit publik, kështu që jemi veçanërisht të kujdesshëm për të shmangur edhe perceptimin e papërshtatshmërisë.

### ZYRTARËT E QEVERISË PËRFSHIJNË


- Çdo anëtar, punonjës ose person që vepron në emër të agjencive qeveritare, ndërmarrjeve shtetërore, ose organizata ndërkombëtare
- Zyrtarët e zgjedhur
- Liderët e partive politike

Të afërmit e zyrtarëve të qeverisë janë subjekt i të njëjtave kufizime.

### MENDONI

- Nëse jeni në një marrëdhënie personale me një zyrtar të qeverisë, duhet t'ia bëni të ditur këtë SICPA's, sepse mund të duket si një konflikt interesi.
- Punonjësit e kompanive private mund të konsiderohen zyrtarë qeverie nëse veprojnë le të themi, në emër të një agjencie qeveritare.

- Për të shmangur ndonjë ndërveprim të papërshtatshëm që mund të ekspozojë zyrtarët e qeverisë ose SICPA's, ne familjarizohemi me rregullat në fuqi.
- Si *Trust Enablers* ("Mundësues të Besimit") për klientët dhe publikun, duhet të jemi veçanërisht të kujdesshëm të mos shkelim asnjë rregull të prokurimit publik duke bërë dhurata ose oferta që mund të shihen si përpjekje për të influencuar procesin e vendimmarrjes.
- Si rregull i përgjithshëm, ne nuk ofrojmë dhurata, kontribute, donacione ose sponsorizime për të paguar për udhëtimin ose argëtimin e zyrtarëve të qeverisë. Çdo përjashtim nga ky rregull, pavarësisht vlerës, kërkon miratimin paraprak nga *Shefi i Pajtueshmërisë* ose të emëruarit e tij.



### SHEMBUJ

- Çdo pagesë për lehtësim e kërkuar nga një zyrtar qeverie, pavarësisht vlerës ose natyrës së saj, duhet kundërshtuar dhe raportuar.
- Ftesa e bërë një zyrtari qeveritar për një darkë të shtrenjtë mund të shihet si korrupsion.
- Përfshirja e një anëtari të familjes së një zyrtari të qeverisë mund të perceptohet si një transaksion i papërshtatshëm dhe kërkon miratim të veçantë.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

## BASHKËPUNIMI ME PALËT E TRETË

**Ne jemi përgjegjës për atë që bëjnë të tjerët në emrin tonë.**

- ✓ Ne sigurohemi që e dimë dhe e kuptojmë se me kë po bëjmë biznes, duke treguar kujdesin e duhur me integritet dhe duke kërkuar dokumentacionin e duhur për shërbimet e tyre.
- ✓ Pasi kemi vendosur të punojmë me një palë të tretë, përpiqemi t'i mbajmë në standardet tona të larta. Puna e tyre ndikon në reputacionin tonë dhe impakti i tyre është përgjegjësia jonë në fund të fundit.
- ✗ Ne kurrë nuk u kërkojmë palëve të treta qofshin këto shitës, nënkontraktorë, këshilltarë tregtarë dhe partnerë të tjerë biznesi, të veprojnë në një mënyrë që nuk është në përputhje me këtë Kod apo ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- ✗ Nëse vetë ne nuk mund të veprojmë pa kompromentuar parimet tona, nuk mund t'u kërkojmë atyre ta bëjnë diçka të tillë në emrin tonë. Ne mbajmë përgjegjësi për veprimet e tyre.

### MENDONI

- Duhet të kemi gjithmonë një arsye të fortë dhe të dokumentuar mirë për të justifikuar angazhimin me një palë të tretë të veçantë.
- Pritshmëritë tona për pajtueshmërinë me këtë Kod zbatohen edhe për partnerët tanë të biznesit dhe njoftimi i tyre varet nga ne. Angazhimi i një pale të tretë me një reputacion në pikëpyetje ose integritet të dobët do të ekspozonte SICPA'n.

### SHEMBUJ

- Kurrë mos u implikoni me një palë të tretë për të anashkaluar kërkesat ligjore ose rregullatore.
- Kurrë mos përdorni një ndërmjetësues nëse nuk e kuptoni rolin e tyre në transaksion, madje edhe (dhe veçanërisht) nëse ua rekomandon një klient.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## LIGJI I KONKURRENCËS

**Ne konkurrojmë në mënyrë të drejtë dhe kurrë nuk përplasemi me konkurrentët.**

- ✓ Ne konkurrojmë në treg duke ofruar zgjidhje novatore dhe të vlefshme për klientët tanë.
- ✓ Ne i kufizojmë ndërveprimet tona me konkurrentët në hapësirën 'para-konkurrese', për shembull, në kontekstin e shoqatave tregtare ose nismat në mbarë industrinë.
- ✓ Në përgjithësi ne operojmë në nivel global në pajtueshmëri me ligjin zviceran dhe të BE-së për konkurrencën, përveç rasteve kur ligjet vendase në fuqi janë më kufizuese.
- ✓ Ne eksplorojmë mundësi të reja biznesi në mënyrë të pavarur nga konkurrentët përveç rasteve kur parashikojmë në mënyrë specifike një projekt përbashkët.

- ⊗ Kurdo që ndërveprojmë me konkurrentët, bëjmë kujdes të mos ndajmë informacionin e ndaluar nga ligji i konkurrencës.
- ⊗ Ne nuk diskutojmë ose biem dakord me konkurrentët se çfarë qasjeje të kemi (ose jo) ndaj klientëve të veçantë apo kategorive të veçanta të klientëve.

### MENDONI

- Edhe një shkëmbim i thjeshtë i informacioneve të ndjeshme tregtare mes konkurrentëve mund të jetë i paligjshëm. Edhe nëse informacionet e ndjeshme shpërndahen ose merren, shkruhen ose thuhën, janë të vërteta apo të rreme, mund ta ekspozojnë SICPA'n.
- Shumica e proceseve të prokurimit publik kanë rregulla konfidencialiteti. Ne nuk i diskutojmë kurrë kushtet e propozimeve të SICPA's me ofertues të tjerë.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

## KONTROLLET E TREGTISË

Ne veprojmë në përputhje me të gjitha sanksionet ndërkombëtare ekonomike dhe tregtare në fuqi.



### Pajtueshmëria

Ne veprojmë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e kontrollit të tregtisë në fuqi, duke përfshirë kufizimet rreth produkteve të veçanta, teknologjive dhe shteteve të destinacionit.



### Monitorimi

Ne monitorojmë vazhdimisht ndryshimet rregullatore dhe bëjmë ndjekjen e tyre, nëse shqetësohemi që flukset e produkteve tona mund t'i shkelin ato.



### Kontrollimi

Ne i kontrollojmë vazhdimisht partnerët tanë të biznesit për ndryshime të mundshme në statusin e tyre të sanksioneve.

### MENDONI

- Mbani parasysh se për shtete me sanksione të larta zbatohen rregulla të veçanta, sipas përcaktimit në politikën e SICPA's.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

## PJESA 05

# INTEGRITETI YNË FINANCIAR

Raportimi financiar i besueshëm, i saktë dhe i ndershëm është vendimtar në matjen dhe monitorimin e performancës sonë.

Si partner i besuar dhe një korporatë e mirë me kontribute për qytetarët, ne nuk përdorim informacione financiare, transaksione ose operacione për të mashtruar ose anashkaluar rregullat.

## NË KËTË PJSË

---

- 5.1 RAPORTIMI FINANCIAR
- 5.2 KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE
- 5.3 MASHTRIMI
- 5.4 DONACIONET POLITIKE DHE BAMIRËSE
- 5.5 LOBIMI DHE ÇËSHTJET POLITIKE

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

---

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

---

03  
NJERËZIT  
TANË

---

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

---

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

---

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

---

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

---



## RAPORTIMI FINANCIAR

Ne përdorim kontrole të fuqishme ndaj transaksioneve dhe raportimeve financiare.

- ✓ Sigurohemi që e dimë sesi fitojmë dhe harxhojmë para.
- ✓ Të dhënat tona kontabël dhe financiare pasqyrojnë sa më saktë dhe plotësisht të jetë e mundur realitetin e operacioneve tona.
- ✓ Ne veprojmë në përputhje me të gjitha standardet e zbatueshme kontabël dhe rregulloret tatimore që kanë të bëjnë me zbulimin dhe ruajtjen e dokumentacionit.

## KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

Ne jemi proaktivë kur bie fjala për mosmarrjen kurrë pjesë në lëvizje të paligjshme financiare.



Si një palë e interesuar e përgjegjshme në sistemin global financiar, **ne veprojmë në përputhje me të gjitha rregulloret financiare në fuqi.**



Ne marrim çdo hap të nevojshëm për **të njohur partnerët tanë të biznesit** dhe burimin e fondeve të tyre.



Ne monitorojmë lëvizjet tona financiare dhe **bëjmë menjëherë ndjekjen e çdo parregullsie të dyshuar.**

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

# MASHTRIMI

Ne veprojmë me sinqeritet dhe integritet në të gjitha transaksionet tona të biznesit.

**Jemi të përkushtuar** të parandalojmë, zbulojmë dhe hetojmë çdo sjellje të pandershme që mund të ndikojë te njerëzit tanë, aktivitetet ose asetet.

**Jemi të përkushtuar** të arrijmë përfitimet më të larta në të gjitha vendimet e prokurimit dhe nuk i përdorim burimet dhe asetet e SICPA's për përfitimin tonë personal.



- ✓ Të gjithëve na kërkohet të ndjekim procese dhe procedura që ekzistojnë për ta mbrojtur kompaninë nga veprimtari mashtruese, si dhe promovojmë një kulturë ndershmërie në të gjitha veprimet tona.
- ⊗ Ne nuk përpiqemi të anashkalojmë rregullat apo të përfitojmë avantazh të panevojshëm duke bërë deklarata të rreme.
- ⊗ Ne as nuk veprojmë me mashtrim për të marrë një përfitim të padrejtë ose të paligjshëm apo përfitim personal, por as nuk lehtësojmë sjelljen mashtruese.

## MENDONI

- Veproni gjithnjë në interesin më të mirë të SICPA's dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi.
- Sigurohuni që përjashtimet nga proceset dhe procedurat ekzistuese të shqyrtohen dhe miratohen në nivelin e duhur.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ


03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## DONACIONET POLITIKE DHE BAMIRËSE

**Ne nuk përpiqemi të influencojmë vendimet përmes donacioneve tona, granteve apo kontributeve bamirëse.**

Përkushtimet tona në angazhimin e komunitetit përfshijnë mbështetjen e nismave bamirëse ose në interes të publikut nëpërmjet kontributeve në natyrë ose financiare.

Kontribute të tilla janë gjithnjë në përputhje me kërkesat përkatëse rregullatore dhe të transparencës dhe nuk përdoren kurrë për të ndikuar në rezultatin e një transaksioni tregtar ose vendimi politik.

Ne i shqyrtojmë nga afër të gjitha kontributet bamirëse para se t'i miratojmë, për të garantuar që janë në përputhje me aktivitetet e biznesit dhe qasjen e angazhimit të SICPA's, si dhe për të shmangur perceptimin për veprime të papërshtatshme.



## LOBIMI DHE ÇËSHTJET POLITIKE

**Në përgjithësi ne nuk përfshihemi në aktivitete lobimi.**

- ✓ Ne angazhohemi me agjencitë qeveritare, si klientë ekzistues ose të ardhshëm, në drejtimin normal të aktiviteteve tona të biznesit.
- ✗ Ne nuk tentojmë të influencojmë në rregulloret ose legjislacionin përmes aktiviteteve të lobimit, në mënyrë direkte ose indirekte.

Çdo mënjanim nga ky rregull i përgjithshëm duhet të qëndrojë rreptësisht brenda kufijve të rregulloreve vendore dhe të kërkojë miratim paraprak nga një anëtar i Komitetit Ekzekutiv.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## PJESA 06

# SJELLJA JONË NË TREG

Ne jemi një partner i besuar për klientët tanë në mbarë globin, të cilët mbështeten te besueshmëria jonë.

Jemi të përkushtuar që të jemi një korporatë me kontribute për qytetarët dhe të vëmendshëm ndaj impaktit tonë në çdo grup të palëve të interesuara me të cilat ndërveprojmë.

## NË KËTË PJESE

- 6.1 SIGURIA E PRODUKTIT
- 6.2 MJEDISI
- 6.3 PRONËSIA INTELEKTUALE
- 6.4 KONFIDENCIALITETI
- 6.5 SIGURIA INFORMATIVE DHE KIBERNETIKE
- 6.6 MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSIA
- 6.7 MBËSHTETJA E KOMUNITETIT
- 6.8 PUNA DHE TË DREJTAT E NJERIUT
- 6.9 ZINXHIRI I FURNIZIMIT

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

**06  
SJELLJA JONË NË  
TREG**

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

#### MENDONI

- Kërkoni dhe mirëpritni përshtypjet e klientëve mbi cilësinë dhe sigurinë e produktit.
- Raportoni të metat e identifikuara ose të dyshuara në produktet apo lëndët tona të para.

## SIGURIA E PRODUKTIT

Ne i projektojmë dhe prodhojmë produktet tona që të jenë sa më të sigurta.



Produktet tona përmbushin **rregulloret në fuqi mbi substancat kimike** në të gjitha tregjet dhe në të gjitha kohët.



Ne drejtojmë **programe** efektive, efikase **të menaxhimit të ndryshimeve** për të ruajtur standardet e sigurisë me kalimin e kohës.



Në SICPA ne i zhvillojmë dhe prodhojmë produktet tona me një vizion afatgjatë duke zgjedhur me kujdes lëndët e para dhe **duke minimizuar rreziqet**.



Ne **monitorojmë në mënyrë proaktive të dhënat e produktit dhe rregulloret**, duke fuqizuar klientët tanë me të gjitha informacionet përkatëse të sigurisë.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

## MJEDISI

**Jemi të përkushtuar për të rritur performancën tonë mjedisore dhe për t'i dhënë një kontribut pozitiv natyrës dhe shoqërisë.**

Ne i marrim shumë seriozisht çështjet mjedisore dhe e dimë se kemi përgjegjësinë tonë në mbrojtjen e të ardhmes së planetit.

Minimizimi i gjurmëve tona në mjedis është një prej përparësive tona. Ne vlerësojmë dhe kërkojmë të reduktojmë impaktin e produkteve dhe operacioneve tona në mjedis.

Jemi të përkushtuar të kryejmë biznes në pajtim me rregullat mjedisore dhe në linjë me kornizat e njohura të zhvillimit të qëndrueshëm.

### NE SYNOJMË VAZHDIMISHT

- ✓ Të rrisim performancën tonë mjedisore në të gjithë zinxhirin tonë të vlerave duke zhvilluar, prodhuar dhe promovuar produkte dhe zgjidhje të qëndrueshme.
- ✓ Të rrisim qarkullimin në operacionet tona dhe zinxhirin e vlerave.
- ✓ Të përkrahim praktikatat e mira të menaxhimit mjedisor me partnerët tanë të zinxhirit të furnizimit.
- ✓ Të përkrahim dhe zbatojmë një zgjedhje dhe përdorim me përgjegjësi të burimeve tona.
- ✓ Të nxisim mbrojtjen mjedisore dhe biodiversitetin.

### MENDONI

- Merrni në konsideratë ndikimin negativ të mundshëm të aktiviteteve tuaja ditore të punës në mjedis dhe gjeni mënyra për ta reduktuar atë.

## NE KËRKOJMË VAZHDIMISHT MUNDËSI PËR TË PËRSHTATUR PROCESET TONA INDUSTRIALE DHE PRAKTIKAT E BIZNESIT DUKE



**Reduktuar** emetimet tona të gazrave serë.



**Kufizuar** përdorimin tonë të substancave të dëmshme.



**Reduktuar** mbetjet tona industriale.



**Zbatuar** praktika efikase të menaxhimit të ujit.



**Optimizuar** përdorimin tonë të energjisë.



**Promovuar** efikasitetin e energjisë, rikuperimin e saj dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

Ne krahasojmë vazhdimisht performancën tonë mjedisore, kërkojmë certifikime të jashtme dhe raportojmë për ecurinë tonë.

Duke u angazhuar me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm, ne kemi një qasje gjithëpërfshirëse për të mbrojtur mjedisin dhe për të përmirësuar performancën tonë.



## PRONËSIA INTELEKTUALE

**Ne mbrojmë pronësinë  
intelektuale të SICPA's dhe  
respektojmë atë të të tjerëve.**

Nga dizajnet deri te të drejtat e autorit, patentat dhe markat tregtare, pronësia intelektuale e SICPA's është rezultat i risive tona kolektive.

SICPA zotëron të drejta të pronësisë intelektuale në shumë teknologji dhe juridiksione që mbështetin strategjinë tonë të biznesit.

- ⊗ Ne nuk i përdorim ose i shpërndajmë ato për përfitim personal ose jashtë një strukture të duhur ligjore.
- ⊗ As nuk e keqpërdorim pronësinë intelektuale ose informacionin konfidencial të të tjerëve në punën tonë.



## KONFIDENCIALITETI

**Ne e kufizojmë aksesimin dhe shpërndarjen e informacioneve konfidenciale vetëm mbi bazën e nevojës për të ditur.**

Ne i mbrojmë informacionet e gjeneruara nga aktiviteti ynë dhe që na janë besuar nga punonjësit dhe partnerët duke i trajtuar në një mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.

Informacione të tilla i trajtojmë si asete strategjike dhe caktojmë burime për ruajtjen dhe sigurimin e tyre.

### MENDONI

- Kushtojini vëmendje nivelit të konfidencialitetit të dokumenteve ose skedarëve me të cilat punoni dhe ndiqni protokollin e duhur të shpërndarjes.
- Sigurohuni që palët e jashtme të firmosin një marrëveshje formale konfidencialiteti para se të ndahen informacione të identifikuar si konfidenciale.

### NE VEPROJMË NË PËRPUTHJE ME TË GJITHA POLITIKAT E BRENDSHME DHE DETYRIMET KONTRAKTUALE MBI TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE KONFIDENCIALE



**Duke identifikuar dhe duke etiketuar qartësisht informacionet** që nuk duhen publikuar në disa nivele konfidencialiteti, sipas shkallës së rëndësisë që kanë.



**Duke kufizuar shpërndarjen e informacioneve** me kolegët dhe partnerët të cilët kanë të drejta specifike për t'i aksesuar.



**Duke u përditësuar** me kërkesat e konfidencialitetit.



Duke garantuar që informacionet konfidenciale në të gjitha formatet **ruhen gjithnjë dhe transferohen në mënyrë të sigurt.**

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

# SIGURIA INFORMATIVE DHE KIBERNETIKE

**Ne i mbrojmë sistemet tona të informacionit nga ndërhyrja, manipulimi dhe rrjedhja.**

Në SICPA ne besojmë se punonjësit tanë janë mbrojtja më e fortë kundër kërcënimeve të sigurisë kibernetike.



**Ne mbështetemi në persona novatorë**, teknologji dhe procese për të përcjellë vlera dhe për të Mundësuar Besim te klientët tanë.



**Ne jemi vigjilentë ndaj kërcënimeve të jashtme** që mund të kompromentojnë përdorimin e sistemeve tona ose integritetin e skedarëve tanë, dhe të marrim të gjitha masat e nevojshme paraprake për t'i reduktuar duke përdorur udhëzimet e ekipit të Sigurisë Kibernetike dhe të Informacionit.



**Ne përditësohemi** me zhvillimet më të fundit dhe kërkesat mbi sigurinë e informacionit, duke zbatuar standartet më të fundit të sigurisë kibernetike, të tilla si siguria që në projektim dhe arritja e çertifikimeve më rigorozë për sistemet tona.

## MENDONI

- Enkriptoni të dhënat e ndjeshme para se t'i ndani me palë të jashtme apo para se t'i merrni me vete në një udhëtim pune.
- Përditësoni kompjuterin dhe telefonin tuaj me versionin më të fundit të softuerit të sigurisë të miratuar nga SICPA.



## SHEMBUJ

- Ne përdorim fjalëkalime komplekse dhe nuk i ndajmë ato me tjerët.
- Ne nuk e lëmë kurrë një kompjuter të hapur dhe të pambikëqyrur në një hapësirë publike.
- Ne nuk i diskutojmë aktivitetet apo biznesin e SICPA's në publik.
- Jemi vigjilentë ndaj tentativave për të nxjerrë informacione nga ne përmes inxhinierisë sociale, imitimit të një drejtuesi të SICPA's ose një sensi të rremë urgjence.
- Ne raportojmë çdo e-mail dhe thirrje telefonike që dyshojmë se mund të çojë në një incident sigurie.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

## MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSIA

**Ne e respektojmë me shumë kujdes  
privatësinë dhe mbrojmë të dhënat.**

- ✓ Ne jemi të përkushtuar për përpunimin e të dhënave personale me kujdesin e duhur, në linjë me ligjet e zbatueshme dhe parimet e privatësisë.
- ✓ Ne e respektojmë gjithmonë privatësinë e individëve për të fituar dhe merituar besimin e tyre.
- ✓ Ne zgjedhim dhe monitorojmë me kujdes palët e treta që u lejohe të përpunojnë ose aksesojnë të dhëna personale për të cilat jemi përgjegjës.

## MBËSHTETJA E KOMUNITETIT

**Ne angazhohemi dhe mbështetim  
komunitetet në vendet ku operojmë.**

- ✓ Ne kërkojmë të kemi një impakt pozitiv social në rajonet ku operojmë.
- ✓ Ne investojmë në ekonominë vendase duke punësuar personel vendas dhe duke punuar me furnitorë lokalë për mallra dhe shërbime.
- ✓ Ne mbështetim aktivitetet sociale, kulturore, arsimore dhe shkencore brenda këtyre komuniteteve përmes donacioneve financiare dhe në natyrë dhe vullnetarizmit të punonjësve.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

## PUNA DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Ne jemi tepërtë përkushtuar për të respektuar të drejtat e njeriut kudo që operojmë.



Ne i respektojmë të drejtat dhe **dinjitetin e punonjësve tanë në të gjitha vendet** ku bëjmë biznes.



Praktikat tona të punës respektojnë **të drejtat njerëzore dhe sociale**.



Ne mbajmë një qëndrim të fortë **kundër punës së fëmijëve** dhe çdo forme pune të detyruar.



## ZINXHIRI I FURNIZIMIT

Ne adresojmë në mënyrë proaktive çdo shkelje të mundshme të këtij Kodi në zinxhirin tonë të furnizimit.

Ne monitorojmë problemet e mundshme që lidhen me veprimtaritë tona në të gjithë zinxhirin e furnizimit të produkteve dhe shërbimeve tona, nga furnitorët deri te klientët duke:

- Gjurmuar origjinën e lëndëve të para dhe duke hetuar për kushtet e punës dhe impaktin mjedisor.
- Siguruar që e dimë sesi përdoren produktet tona dhe nga kush.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## PJESA 07

# KËRKIMI I NDIHMËS DHE UDHËZIMIT

Ne i nxitim njerëzit tanë dhe partnerët e biznesit të pyesin për informacione dhe këshilla kurdoherë që nuk janë të sigurt se çfarë pritët prej tyre.

Nëse keni shqetësime në lidhje me zbatimin e Kodit tonë, politikave ose procedurave, duhet të ndiheni të lirë t'i ngrini ato pa ndonjë frikë për hakmarrje.

### NË KËTË PJESE

---

- 7.1 KË TË PYESNI
- 7.2 NGRITJA E SHQETËSIMEVE  
- *SPEAK UP*

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

---

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

---

03  
NJERËZIT  
TANË

---

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

---

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

---

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

---

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

---

## KË TË PYESNI

Jeni i hutuar ose i shqetësuar? Ka burime të ndryshme në dispozicionin tuaj për t'ju ndihmuar të qartësoni një situatë. Ndalesa juaj e parë janë politikat globale dhe lokale në intranetin e SICPA's.



Duhet të lexoni dhe të siguroheni që i kuptoni të gjitha politikat e SICPA's dhe bëni të gjitha modulet e trajnimit që përkojnë me veprimtaritë tuaja.



Për ndonjë qartësim të mëtejshëm apo pyetje, mos hezitoni të pyesni menaxherin tuaj ose çdo menaxher nga departamentet si Burimet Njerëzore, Financa, Pajtueshmëria, Çështjet Ligjore ose Shëndeti dhe Siguria, qoftë në nivel lokal ose në zyrat qendrore globale.

Menaxherët e SICPA's i mirëpresin pyetjet dhe shqetësimet nga të gjithë punonjësit.



01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT



## NGRITJA E SHQETËSIMEVE – *SPEAK UP*

**Ne nxitim çdo punonjës të SICPA's dhe palë të jashtme të interesuar të ngrenë zërin nëse kanë ndonjë shqetësim dhe do t'i dëgjojmë dhe mbështetim kur ta bëjnë.**

### **LINJA SPEAK UP E SICPA**

Nëse nuk jeni komod me idenë e ngritjes së një shqetësimi ballë për ballë me menaxherin tuaj ose për ta diskutuar hapur me departamentet e tjera, mund të përdorni *Linjën Speak Up* të SICPA's (mjeti ynë sinjalizues). Ajo është në dispozicion 24 orë të ditës brenda dhe jashtë, operohet nga një palë e tretë përmes një portali uebi dhe qendre thirrjesh. Ata dot'ju japin opsionin të raportoni në mënyrë anonime.

Cilëndo rrugë të ndiqni, **shqetësimi juaj do të merret seriozisht** dhe do të menaxhohet me nivelin e duhur të konfidencialitetit.

SICPA ka një **politikë kundër hakmarrjes dhe nuk do të tolerojë asnjë hakmarrje kundër një sinjalizuesi** që raporton në mirëbesim.

Çdo formë hakmarrjeje, duke përfshirë efektet e mundshme negative në karrierën e tyre, pagesën, reputacionin apo kushtet e punës, është në shkelje të qartë me politikën e SICPA's.

01  
BESIMI ËSHTË  
BIZNESI YNË

02  
PËRGJEGJËSIA  
JUAJ

03  
NJERËZIT  
TANË

04  
INTEGRITETI I  
BIZNESIT TONË

05  
INTEGRITETI YNË  
FINANCIAR

06  
SJELLJA JONË NË  
TREG

07  
KËRKIMI I NDIHMËS  
DHE UDHËZIMIT

Në këtë Kod Sjelijeje, gramatika e gjinisë mashkullore është përdorur me një vlerë të përgjithshme dhe jo të veçantë, e kuptuar si një gjini e pashënuar që përfshin tërësinë e individëve dhe zbatohet për të gjithë bashkërisht dhe në mënyrë të pandashme.

Kjo version i përkthyer jepet vetëm për lehtësi dhe versioni në gjuhën angleze i këtij Kodi Sjelijeje mbizotëron në rastin e mospërputhjeve mes dy versioneve.



**SICPA**

World Headquarters  
Av de Florissant 41  
1008 Prilly  
Switzerland

Tel +41 21 627 55 55  
Fax +41 21 627 57 27  
info@sicpa.com  
www.sicpa.com

Pikat nëpër botë:  
[www.sicpa.com/map](http://www.sicpa.com/map)

© 2023 SICPA HOLDING SA, Switzerland

SICPA është e certifikuar me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 17025:2017 dhe ISO 37001:2016, sipas një programi botëror, në strukturën e një Sistemi Menaxhimi të Integruar unik.

Të gjitha materialet në këto faqe, duke përfshirë tekstin, faqosjen, prezantimin, logot, ikonat, fotot dhe të gjitha veprat e tjera artistike duke përfshirë punët derivate, janë pronësi intelektuale e SICPA's (për qëllim të këtij dokumenti fjala "SICPA" do të thotë SICPA HOLDING SA ose kompanitë e saj mëmë ose degët) nëse nuk është parashikuar ndryshe dhe mbrohet nga emrat tregtare, patentat ose e drejta e autorit.

Nuk autorizohet asnjë riprodhim, përdorim derivat ose tregtar i materialeve pa lejen paraprake me shkrim të SICPA's. Informacioni që gjendet në këto faqe apo që rrjedh nga këto faqe nuk do të përdoret për zhvillimin, prodhimin, marketimin e çdo produkti apo shërbimi ose për ndonjë qëllim pa lejen paraprake me shkrim të SICPA's.